



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PATENTAVE DHE MARKAVE



SH.P.A.L "UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA"

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
PATENTAVE DHE MARKAVE

SHKOLLA PRIVATE E ARSIMIT TË LARTË
"UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA"

Nr. ²²⁰ Prot., datë ^{6.7} .2016

Nr. ¹⁵⁷⁷ Prot., datë ^{06.07} .2016

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET:

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PATENTAVE DHE MARKAVE
(DPPM)

DHE

SHKOLLËS PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË "UNIVERSITETI METROPOLITAN
TIRANA"

Gen

KY MEMORANDUM BASHKËPUNIMI LIDHET NDËRMJET:

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PATENTAVE DHE MARKAVE

e njohur më poshtë si “DPPM”, është një institucion publik, që siguron dhënie dhe mbrojtjen e objekteve të Pronësisë Industriale, në fushat e shpikjeve dhe modeleve të përdorimit, markave tregtare dhe të shërbimit, disenjove industriale, treguesëve gjeografikë, topografive dhe qarqeve të integruara. Zyra për regjistrimin e Markave Tregtare ka funksionuar pranë Dhomës së Tregtisë së Shqipërisë që në vitin 1957. Me Ligjin Nr.7819 veprimtaria e Dhomës së Tregtisë i kaloi Zyrës së Patentave dhe Markave e cila u krijua me V.K.M Nr. 135 , dt. 22 Mars 1993. Sot, Drejtoria Përgjithshme e Patentave dhe Markave është institucion publik në varësi të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Veprimtaria e saj përcaktohet dhe rregullohet me Ligjin nr. 9947 dt. 07/07/2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar, i regjistruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me numër identifikimi K51726018J. Adresa e institucionit është: Bulevardi “Zhan D’Ark”, ish Shtëpia e Ushtarakëve, Prona Nr. 33, Tiranë, i përfaqësuar nga Titullari:

Z. Elvin LAKO – Drejtor i Përgjithshëm

DHE

SHKOLLËS PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË “UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA”

e njohur më poshtë si SHPAL “Universiteti Metropolitan Tirana” financohet nga një grup investitorësh në fushën e inxhinierisë, arkitekturës, teknologjisë dhe ekonomisë, themeluar nga “Future University of Tirana” shpk, me mision edukimin, kërkimin shkencor, inovacionin dhe zhvillimin e talenteve të reja në fushën e biznesit shqiptar. SH.P.A.L Universiteti Metropolitan Tirana është licencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 357, datë 12. 05. 2010 “Për Licencimin e Shkollës Private të arsimit të lartë “Universiteti Metropolitan Tirana”, Tiranë”. Misioni i SHPAL “Universitetit Metropolitan Tirana” është përgatitja e drejtuesve të rinj të biznesit shqiptar dhe specialistëve të lartë në fushën e inxhinierisë, arkitekturës, ekonomisë dhe teknologjisë së informacionit, të aftë për të punuar si në tregun e brendshëm dhe në atë rajonal dhe europian. Për të realizuar këtë mision, SH.P.A.L "Universiteti Metropolitan Tirana" ka si objektive: Pozicionimin në tregun shqiptar me specialistë të formuar dhe të kualifikuar në të gjithë sektorët e biznesit Aftësimin e studentëve për kualifikime e publikime të mëtjshme në fushën e tyre. Përmirësimin e vazhdueshëm të programit akademik, bazuar në përvojat më të mira ndërkombëtare. Investimin në kërkimin shkencor, si një karakteristikë e programit të studimit të ciklit të dytë dhe të Masterit Profesional, tashmë inkuadruar edhe në ciklin e parë Sigurim akomodimi me kushte shumë të mira për studentët dhe nxitjen e veprimtarive sociale, të dijes e të kulturës nga studentët ose organizimet e tyre. Me qëllim përmbushjen e objektivave SH.P.A.L “Universiteti Metropolitan Tirana” parashikon



për vitin akademik 2014-2015 hapjen e dy degëve të reja, përkatësisht Master Shkencor në Arkitekturë Inxhinierike dhe Bachelor në Financë- Kontabilitet, në bazë të aplikimit Nr. 149 Prot. datë 28.02.2014, dorëzuar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit . Masteri Shkencor në Arkitekturë përfshin një cikël studimesh të integruara 5-vjeçare. SH.P.A.L "Universiteti Metropolitan Tirana" përmban dy fakultete: Fakultetin e Inxhinierisë dhe Fakultetin e Ekonomisë. Fakulteti i Inxhinierisë përbëhet nga Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Departamenti i Inxhinierisë Elektrike dhe Teknologjisë së Informacionit. Ndërsa, Fakulteti i Ekonomisë përbëhet nga Departamenti i Administrimit të Biznesit dhe Departamenti i Informatikës Ekonomike. Pranë çdo fakulteti funksionon edhe një qendër e veçantë kërkimore shkencore. Adresa e institucionit është: Godina qendrore, Rruga "Pjetër Budi" dhe "Sotir Kolea" pranë "Qytetit Studenti" Tiranë, i përfaqësuar nga Titullari:

Prof Dr. Z.Gëzim KARAPICI – Rektor

Neni 1

Rëndësia e Bashkëpunimit

Duke patur parasysh se:

1. Pronësia Industriale është një shtyllë e rëndësishme për ngritjen dhe zhvillimin e një veprimtarie të qëndrueshme ekonomike.
2. Ekziston një nevojë imediate për mbështetjen ligjore dhe institucionale të pronësisë industriale, me qëllim mbrojtjen e subjekteve të kësaj pronësie .
3. Palët janë të interesuara të promovojnë dhe të përmbushin objektivat e përgjithshme për mbrojtjen e pronësisë industriale, si dhe të drejtave të Institucioneve të Arsimit të Lartë që angazhohen në këto veprimtari.
4. Palët shprehin dakortësinë mbi rëndësinë e ndërgjegjësimit publik mbi pronësinë industriale, përsa i përket kontributit të rëndësishëm të Institucionit të Arsimit të Lartë SH.P.A.L "Universiteti Metropolitan Tirana", në zhvillimin edukativ arsimor të Shqipërisë.

Palët bien dakord të nënshkruajnë këtë Memorandum Bashkëpunimi, sipas modaliteteve të mëposhtme:

Neni 2

Qëllimi i Bashkëpunimit

1. Informimi dhe sensibilizimi i studentëve dhe i rretheve të tyre sociale, duke iu vënë në dispozicion dispozitat ligjore mbi pronësinë industriale.
2. Promovimi i pronësisë industriale nëpërmjet shkëmbimit të informacionit midis dy institucioneve tona.
3. Identifikimi i masave të mbrojtjes së pronësisë industriale.



Neni 3

Objektivat e Marrëveshjes

Objektivi kryesor i Marrëveshjes është të lehtësojë njohjen e konceptit të pronësisë industriale nëpërmjet:

1. Identifikimit të mekanizmave të shpërndarjes së informacionit në lidhje me pronësinë industriale, ku në bashkëpunim me studentët t'i përçohet informacioni dhe njohuria: subjekteve, bizneseve dhe përdoruesve të tjerë të pronësisë industriale.
2. Shpërndarjes së materialeve informuese në lidhje me bizneset, veprimtaria e të cilëve është e lidhur me pronësinë industriale.
3. Trajnimit të studentëve dhe përmes tyre edhe bizneseve mbi rëndësinë e pronësisë industriale.
4. Organizimit të konferencave të përbashkëta, trajnimeve brenda dhe jashtë vendit, internshipeve, leksioneve të hapura, seminareve, sesione bisedimesh (workshops), praktikave mësimore apo takimeve, në fushën e biznesit, dhënien e njohurive praktike nga specialistët e kësaj drejtorie, përsa i përket pronësisë industriale.
5. Shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit në lidhje me funksionin dhe kontributin e SH.P.A.L "Universiteti Metropolitan Tirana" në zhvillimin, zgjerimin dhe sensibilizimin e opinionit publik.

Neni 4

Modalitetet e Bashkëpunimit

1. Secila palë do të caktojë një koordinator të Marrëveshjes, përgjegjës për zbatimin e saj; konkretisht nga ana e SH.P.A.L "Universiteti Metropolitan Tirana" do të jetë Drejtorja e Komunikimit dhe nga DPPM do të jetë Drejtorja e Koordinimit, Promovimit të PI-së dhe Trajnimit.
2. Ngritja e një grupi të përbashkët pune për konkretizimin e bashkëpunimit me veprimtaritë te ndryshme.
3. Organizimi dhe vënia në dispozicion për publikun e gjerë, të informacionit dhe rezultateve të çdo veprimi të përbashkët, përmes medias së shkruar dhe asaj vizive.
4. Grupet e përbashkëta do të përpunojnë mënyrat dhe veprimet e përbashkëta, për përbushjen e qëllime të kësaj Marrëveshje.

Neni 5

Afati i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje lidhet për një afat të pacaktuar.

Përmbajtja e kësaj marrëveshjeje mund të ndryshojë me pëlqimin me shkrim të të dyja palëve.



Kjo marrëveshje mund të shfuqizohet me kërkesën e njërës palë, pas njoftimit paraprak me shkrim, që parashtron edhe arsyet e prishjes së marrëveshjes.

Neni 6

Nënshkrimi dhe Hyrja në fuqi

Ky Memorandum Bashkëpunimi nënshkruhet sot më dt.04.07.2016, në katër kopje origjinale me vlerë të njëjtë, dy për secilën palë dhe hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të dyja palët.

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E PATENTAVE DHE MARKAVE**


**SHKOLLA E LARTË UNIVERSITARE PRIVATE
“UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA”**

Z. Elvin LAKO

Prof. Dr. Z. Gëzim KARAPICI

Drejtor i Përgjithshëm

Rektor



A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Elvin Lako', is written over a faint circular stamp. The signature is bold and stylized.



A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Gëzim Karapici', is written over a faint circular stamp. The signature is bold and stylized.



A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Gëzim', is written at the bottom left of the page.